

VENDIM
Nr. 142, datë 6.3.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 649, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE,
NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR
PROFESIONET E RREGULLUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndarja V, në shtojcën 1, “Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, bashkëlidhur vendimit nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“V. PROFESIONI I FIZIOTERAPISTIT, ME DIPLOMË NË “FIZIOTERAPI” OSE “SHKENCA REHABILITIMI”.”.’

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama